



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkollat e mesme teknike profesionale (kurrikula e vjetër)

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Mjeda****Andrra e jetës**

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë****Atmosfera**

- Jemi në dimër, shkreti në natyrë, vetmi, ftohtësi, bien ortekët dhe era të than.

Funksioni

- Një paraqitje e tillë e natyrës dhe e mjedisit thekson vetminë, shkretinë e Lokes. Theksohet ana njerëzore.

OSE

Autori vendos një paralelizëm (figurativ) mes natyrës dhe gjendjes shpirtërore dhe fizike të njeriut, për të theksuar këtë të fundit.

1 pikë Nëse përshkruan me pak fjalë atmosferën që mbizotëron në këtë fragment.

DHE

1 pikë Nëse tregon se cili është funksioni i një zgjedhjeje të tillë nga ana e autorit.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 8 **3 pikë****Momenti**

- Lokja ndodhet në fund të jetës së saj.

Ndjesitë

- Lokja ndihet në kulm të dhimbjes dhe dëshpërimit, aq sa thërret dhe vdekjen ta marrë.

Arsyeja

- Është vetëm, pa njeri, e varfër, e braktisur.

1 pikë Nëse tregon se në ç' moment të jetës ndodhet Lokja.

DHE

1 pikë Nëse tregon ndjesitë që ajo po përjeton.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtyre përjetimeve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 **2 pikë****Ritmi**

- Ritmi i këtij fragmenti është i ngadaltë, si i zvaritur, i qetë.

Arsyeja

- Ky lloj ritmi është në funksion të idesë që përpiqet të përçojë autori: një jetë që po mbyllet, pa forcë, pa gjallëri, pa ritëm, një jetë që po zvarritet drejt fundit.

1 pikë Nëse përcakton ritmin e kësaj kënge.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e kësaj zgjedhjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **2 pikë****Model përgjigjeje*****Përgjigje e plotë***

- Në vargun e dhënë drita është përdorur sa në kuptim të drejtpërdrejtë, aq edhe në kuptim figurativ. Imazhi i krijuar është i fuqishëm. Lokja është vetëm, pa njeri, pranë dritës së qiririt, në varfërinë e saj të skajshme. Këtu drita merr dhe një kuptim simbolik. Ajo simbolizon jetën, por tashmë një jetë që po *venitet*, fiket, shuhet.

Përgjigje e pjesshme (Nuk theksohet zbërthimi i nëntekstit)

- Lokja shikon jetën që po i venitet.
- Drita është jeta e saj që po shuhet.

2 pikë Nëse zbërthen në mënyrë të plotë nëntekstin e vargut.

OSE

1 pikë Nëse zbërthen në mënyrë të pjesshme nëntekstin e vargut.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- **Sinonimi:** e shuemja – *e mjera, e gjora*.
- Kjo fjalë mbart një ngarkesë të fortë emocionale, duke theksuar pikërisht të mbeturit pa asgjë, pa njerëz, pa shpresë, të varfër, të braktisur, të shuar nga jeta dhe dëshirat.
- Shqipja standarde: *e shuara*

1 pikë Nëse gjen sinonimin e fjalës.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon ngarkesën emocionale që mbart fjala.

DHE

1 pikë Nëse shkruan trajtën standarde të fjalës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- **Figura bazë:** personifikim (ose prozopope), të dy strofat ndërtohen mbi të.

Komenti

- Të dy vargjet krijojnë një përfytyrim të gjallë të vdekjes, që duket sikur ka trajta (*buzë*), këto janë të zhveshura (*t'shpulpueme*) dhe duket sikur vepron (*ia nguli*). Vdekja nuk lajmëron, e hap derën vetë. Vjen lehtë, në mënyrë tinëzore, befás, merr trajta njerëzore dhe ti mund ta përfytyrosh.

1 pikë Nëse përcakton figurën bazë të stilistikës.

DHE

2 pikë Nëse e komenton imazhin, mbështetur në fjalët kyç që krijojnë imazhin.

OSE

1 pikë Nëse e komenton imazhin, pa theksuar fjalët kyç, që japin thelbin e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II**Flober****Zonja Bovari**

Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	D	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- **Konflikti bazë:** Ema është krejtësisht e pakënaqur me jetën e saj dhe e motivuar për të pasur një më të mirë, por ajo nuk mund ta krijojë idealin perfekt që ajo imagjinon.

OSE

- **Konflikt emocional:** Ema është plot emocione, ndjenja, në një mjedis të zbrazët, ku askush nuk e dëgjon dhe vlerëson, as i shoqi që nuk e kupton.

OSE

- **Konflikt intelektual:** Ema ka disa talente, por ato nuk kanë asnjë vlerë për mjedisin ku jeton. Ajo i bie pianos, por askush s'e dëgjon apo shijon muzikën që ajo luan.. Ajo vizaton, qëndis, por askush s'i vlerëson gjërat që ajo bën.

1 pikë Nëse zbulon konfliktin themelor.

DHE

1 pikë Nëse e shpjegon konfliktin që ka identifikuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (a) **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Ema e trajton Sharlin me zemërim dhe përbuzje.

Arsyeja

- Ajo fajëson atë për kufizimet në jetën e saj, për të qenit e palumtur dhe e perealizuar.

1 pikë Nëse tregon se si e trajton Ema Sharlin.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e sjelljes së saj kundrejt tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Ema ka një koncept të papranueshëm për lumturinë. Ajo gjithnjë ka imagjinuar një jetë plot luks dhe pasion.
- Ky koncept është jo realist pasi ajo është martuar me një burrë të thjeshtë, naiv dhe që i takon shtresës së mesme. Nga ana tjetër ajo jeton në provincë, ku është vështirë të realizohesh dhe jetosh jetën që dëshiron. Pra ajo çfarë ëndërron bie ndesh me realitetin në të cilin Ema jeton, atë personal dhe atë që e rrethon.

1 pikë Nëse shpjegon se cili është koncepti i Emës për lumturinë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon pse ky koncept nuk është realist.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 (a) 3 pikë**Model përgjigjeje**

- Ema pret një ndryshim në jetën e saj. Se si do të jetë ky ndryshim, ajo se ka të qartë. Por ajo pret diçka ndryshe, diçka që të mos i ngjasojë jetës monotone dhe pa emocione që bën.

Figuracioni:

- **Krahasimi:** *si detarët në rrezik për t'u mbytur*
- **Epitetet:** *të dëshpëruar, të bardhë,*
- **Metaforat:** *velë të bardhë në mjegullnajën e horizontit, mjegulla.*
- Ema ndodhet në kulmin e dëshpërimit. Ajo e shikon jetën e saj pa asnjë rrugëdalje, ashtu si detarët (krahasimi) në kërkim të tokës së shpëtimit. Ajo kërkon të shpëtojë nga vetmia që e ka rrethuar, nga zbrazëtia dhe kotësia që po i marrin frymën, si mjegulla kur pushton tokën dhe ti s' sheh asgjë dhe as mbushesh dot me frymë.

1 pikë Nëse tregon se çfarë pret Ema vazhdimisht.

DHE

2 pikë Nëse e komenton se si jepet figurativisht kjo pritje (të paktën me dy figura).

OSE

1 pikë Nëse e komenton pritje, por pa u fokusuar shumë në anën figurative ose duke nënvizuar vetëm një figurë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Ema kalon disa gjendje shpirtërore: nervozizëm, bezdi, mërzi, acarim, deri në patetizëm.
- Pasojat janë: Ema braktis gjithçka, humbet interesin dhe zhytet në vetmi dhe kotësi.

1 pikë Nëse tregon si ndihet Ema në lidhje me situatën që po kalon.

DHE

1 pikë Nëse tregon se cilat janë pasojat e këtij përjetimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 1 pikë

- Mërzitja dhe kotësia e Emës kthehet në një nga temat bazë të veprës dhe mjeti kryesor për zhvillimin e karakterit të saj.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen se pse Floberi i kushton kaq shumë rëndësi mërzitjes dhe kotësisë në jetën e Emës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 2 pikë**Model përgjigjeje**

Ironia nuk vjen e drejtpërdrejtë, por në nëntekst: veprimet e Sharlit dhe ato të Emës.

Detajet që japin thelbin e natyrës dhe veprimeve që bën Sharli. Ironia nënkuptohet pikërisht në detajet që i takojnë sjelljes dhe pamjes së tij.

- *lëpinte dhëmbët me gjuhë,*
- *rrufiste supën,*
- *kuaçiste si kllloçkë në çdo gllënjë*
- *dhjamosja po e zaptonte*
- *sytë të vecërr,*
- *mbufatjes së mollëzave.*

Shpjegimi:

Sharli me veprime të trasha, Ema lexon pjesë romani, drama, gazeta, i bie pianos, vizaton dhe qëndis.

OSE

- Sharli njeri i gjallë ishte, gjithmonë e dëgjonte me vëmendje;
- gjithmonë ia miratonte ato që i thoshte;

Por Ema ia hap zemrën *zagarit*, pasi e di që Sharli s'e kupton, pasi ai *gjithmonë e më shumë* po fitonte *shprehi prej të pagdhenduri*. Floberi s'e thotë, por në nëntekst ndihet kjo mungesë kuptimi dhe komunikimi midis tyre, ndaj me një ironi të fshehur ai pohon se për Emën njësoj ishte: si të fliste me Sharlin si të fliste me zagarin, si të fliste me *kërcunjtë e oxhakut dhe me lavjerrësin e sahatit*.

1 pikë Nëse identifikon një rast të përdorimit të ironisë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon thelbin e kësaj ironie, ku qëndron ajo.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku të shpjegojë rëndësinë që marrin detajet në vepër dhe mjeshtërinë e Floberit në përdorimin e tyre dhe sidomos karakterizimin e personazheve, të tipareve dhe sjelljeve të tyre;
- përdor ilustrime nga fragmenti ose vepra për të mbështetur shpjegimet e dhëna;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.